



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 05 Janar 2022

Nr: 01

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE  
NR. 02, DATË 24.12.2021 DREJTUAR KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE, PËR VENDOSJE SANKSIONI ADMINISTRATIV

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.01.2022, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - Relator  
Elvin LAKO - Anëtar  
Ilijar RUSMALI - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”

**BAZË LIGJORE:** Neni 21, pika 1, shkonja “dh” dhe pika 3 e nenit 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17, 18, 34, 35, 36, 40, 41 dhe 45 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



## Rrethanat e çështjes:

1. Administrata e KQZ-së, bazuar në udhëzimin nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, nga datat 14.10.2021 deri më 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore.
2. Në bazë të nenit 19, pika 1, shkronja “c”, pika 2, nenit 167/2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bëri këqyrjen me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit, vlerësimit dhe numërimit të votave.
3. Në përfundim të procesit të këqyrjes, duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të referuara në raportin e vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”, u rekomandua marrja e masave organizative të cilat synojnë rritjen e efikasitetit dhe vendimmarrjes së administratës zgjedhore të nivelit të tretë. Njëkohësisht, për shkeljet e konstatuara, u rekomandua vijimi i procedurave të mëtejshme administrative për vendosjen e sanksioneve administrative apo kallëzimin e tyre pranë organeve ligjzbatuese për shkeljet e konstatuara.
4. Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “c” dhe pikës 3 të nenit 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 35 në vendimin nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, pikës 3 si dhe lidhjes 3 në raportin e vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kërkon të vërë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve nëpërmjet kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 për sekretarët e KQV-ve, për shkelje të dispozitave



të nenit 41 të Kodit Zgjedhor, duke kërkuar të vendoset masa e sanksionit administrativ më gjobë në masën 30,000 – 60,000 Lekë për 31 Sekretarë të KQV-ve.

5. KAS-i, pasi caktoi me short relatorin z. Elvis Çefa, vendosi të pranojë për shqyrtim kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe caktoi datën 05.01.2022 për shqyrtimin e tij.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave,

### **KAS-i konstatoi:**

1. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ, administratës zgjedhore për shkelje të konstatuara gjatë hetimit administrativ të kryer, vlerëson se KSHZ me vendimin nr. 470, datë 03.12.2021 ka miratuar formalisht raportin e gjetjeve kryesore të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021. Në këtë kontekst KAS vlerëson se nga ana e Komisionerit nuk është zhvilluar një procedurë e mirëfilltë hetimore administrative sidomos në drejtim të vlerësimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar të provave dhe fakteve me qëllim jo vetëm verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit, vlerësimit dhe numërimit të votave, por kryesisht të ngarkimit të tyre me përgjegjësi ligjore në lidhje me funksionin e ngarkuar në procesin zgjedhor.
2. Në këtë kontekst, procedura hetimore e zhvilluar nga KSHZ nuk është e plotë dhe nuk kënaq në mënyrë shteruese kërkesat e ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe neneve 77 e vijues, të Kodit të Procedurave Administrative, sa i përket hetimit dhe përcaktimit të përgjegjësisë konkrete për secilin nga personat për të cilët është kërkuar masë administrative.
3. Gjithashtu, KAS konsideron të domethënës faktin që në këtë proces administrativ, vetë personat e interesuar ndaj të cilëve është propozuar sanksion me gjobë nga Komisioneri u treguan pasivë, duke mos marrë pjesë në seancë megjithëse ishin njoftuar rregullisht dhe kishin dijeni për zhvillimin e saj.
4. Mungesa e interesit të personave të interesuar për të qenë pjesë aktive e procesit dhe për të dhënë shpjegimet apo prapësimet e tyre lidhur me gjetjet e KSHZ do të interpretohet nga ana e



KAS si një pranim apo dakordësim i tyre me shkeljet e pretenduara/konstatuara nga Komisioneri.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 45 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në masën 30 000 Lekë për secilin nga 31 (tridhjetënjë) Sekretarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvis ÇEFA - Relator**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**



**Lista e Sekretarëve të KQV-ve qe nuk kanë administruar / administruar të paplotësuar tërësisht LPM**

<b>Nr.</b>	<b>ZAZ</b>	<b>QV</b>	<b>Emër Atësi Mbiemër</b>	<b>Funksioni</b>
1	1	0027	Palok Llesh Delaj	Sekretar
2	11	0616	Malvin Xheme Koldashi	Sekretar
3	11	0654	Zikri Qamil Beqaj	Sekretar
4	14	0891	Emirljan Gjin Kolli	Sekretar
5	13	0705	Arti Pjeter Hila	Sekretar
6	20	1311	Bektash Hajdar Gega	Sekretar
7	20	1322	Pal Mëhill Zymi	Sekretar
8	33	1768/1	Paola Rober Kotani	Sekretar
9	33	1771	Rozeta Teferik Mersinaj	Sekretar
10	42	2163	Mikel Muharrem Haka	Sekretar
11	44	2267	Lutfi Dalip Saliu	Sekretar
12	44	2265	Baftaj Demir Lapa	Sekretar
13	55	2876	Gentian Arben Xhoxhi	Sekretar
14	70	3834/1	Istref Dulellari	Sekretar
15	85	4487/1	Eligert Egjell Malushaj	Sekretar
16	87	4571	Aleksandra Avni Arshiaj	Sekretar
17	91	4629	Mersin Maksut Leka	Sekretar
18	17	0939	Erjon Mehmet Hutra	Sekretar
19	29	1536/1	Altin Mexhit Brari	Sekretar
20	47	2381	Florenc Ramazan Meta	Sekretar
21	57	3172	Nuredin Ysmet Gega	Sekretar
22	58	3132	Klodian Shefit Buzi	Sekretar
23	60	3054	Besjan Shefit Caushaj	Sekretar
24	72	4023	Demirsha Sheqadet Medolli	Sekretar
25	83	4416	Paolo Ismail Haruni	Sekretar
26	30	2079/2	Dalina Astrit Shehu	Sekretar
27	66	3451	Nexhmedin Veli Kallanxhiu	Sekretare
28	30	1603	Agim Haxhi Sollaku	Sekretar
29	23	1493/1	Neritan Xhevdet Balla	Sekretar
30	6	0182	Sulejman Ali Hasmegaj	Sekretar
31	30	1609	Ledian Fatmir Topalli	Sekretar

